

University for Business and Technology in Kosovo

## UBT Knowledge Center

---

Theses and Dissertations

Student Work

---

Summer 6-2020

# PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT SI PARAKUSHT PËR ANËTARËSIMIN NË BE

Erza Alishani

*University for Business and Technology - UBT*

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Law Commons](#)

---

### Recommended Citation

Alishani, Erza, "PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT SI PARAKUSHT PËR ANËTARËSIMIN NË BE" (2020). *Theses and Dissertations*. 1858.

<https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd/1858>

This Thesis is brought to you for free and open access by the Student Work at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in Theses and Dissertations by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact [knowledge.center@ubt-uni.net](mailto:knowledge.center@ubt-uni.net).



Fakulteti Juridik

**PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT SI PARAKUSHT PËR  
ANËTARËSIMIN NË BE**

Shkalla Bachelor

Erza Alishani

Qershor, 2020

Prishtinë





Fakulteti Juridik

Punim Diplome

Viti akademik 2015/2016

Erza Alishani

**PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT SI PARAKUSHT PËR ANËTARËSIMIN  
NË BE**

Mentori: Dr. Artan Murati

Qershor/2020

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të pjesshme  
për Shkallën Bachelor



## **ABSTRAKTI**

Në këtë punim të bachelorit me temë: “ Përafrimi i legjislacionit si parakusht për anëtarësimin në BE” jam përpjekur të analizoj legjislacionin e Republikës së Kosovës se a është në rrugën e duhur drejt përafrimit të tij me atë të Bashkimit Evropian. Ky punim ka për qëllim diskutimin e kësaj çështjeje duke e ditur vlerën dhe rëndësinë e tij pasi që është njëri prej kriterëve apo kushteve themelore për integrimin në Bashkimin Evropian.

Gjatë këtij punimi, gjithashtu, është diskutuar edhe përafrimi i legjislacionit në përgjithësi, është diskutuar për procesin e zgjerimit dhe për kushtet që shtetet synuese për integrim në BE duhet të plotësojnë. Po ashtu, është diskutuar edhe për sfidat dhe vështirësitë e shumta që ka ky proces dhe për mekanizmat shtetërore që përdoren për ta mundur përafrimin e legjislacionit vendor në mënyrë sa më të mirë.

Në fund ky punim do të përfundojë me krahasimin midis Kosovës dhe shteteve fqinje si Shqipëria, Mali i Zi dhe Serbia se ku qëndrojnë ato në këtë proces dhe ku qëndrojnë ne.

## **MIRËNJOHJE/FALËNDERIME**

Nëpërmjet kësaj deklarate pohoj se punimin e temës së bachelorit me titull: "Përafrimi i legjislacionit me BE-në si parakusht për antarësimin në BE", e kam mbaruar sipas rregullave të parapara me statut të Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), Prishtinë, Drejtimi: Juridik.

Të gjitha pjesët të cilat janë marrë nga tekstet e caktuara, janë të shënuara me referencë. Gjithashtu, me plot përgjegjësi deklaroj se punimin në fjalë nuk e kam dorëzuar kund tjetër, pos tek mentori dhe komisioni i caktuar.

Kam kënaqësinë, gjithashtu, të shpreh mirënjohjen më të thellë për personat, që kanë dhënë mbështetjen e tyre gjatë gjithë kohës sa kam punuar në këtë temë diplome.

Mentorit, Prof. Dr. Artan Muratit, i takon falënderimi më i veçantë për ndihmën, koordinimin dhe udhëheqjen profesionale gjatë punës së këtij punimi.

Falënderoj, po ashtu familjen time e cila më ka përkrahur vazhdimisht në çdo sferë të jetës sime.

Faleminderit!

# **PËRMBAJTJA**

<b>1. Hyrje</b> .....	4
<b>2. SHQYRTIMI I LITERATURES</b> .....	5
2.1 Procesi i zgjerimit të BE-së: kushtet për anëtarësim.....	5
2.1.1 Kushtet për anëtarësim në BE.....	6
2.2 Përafrimi i legjislacionit si kusht për anëtarësim në BE.....	8
2.3 Përafrimi i legjislacionit dhe Kosova.....	10
2.4 Hyrje e përgjithshme.....	11
2.5 Bashkëpunimi BE - Kosovë në përafrim të legjislacionit .....	12
2.6 Mekanizmat shtetëror të Republikës së Kosovës për përafrim të legjislacionit.....	13
2.6.1 Komisioni Parlamentar për integrim Evropian. ....	14
2.6.2 Departamenti i së drejtës së BE-së në kuader të ministrisë së Integritimit Evropian .....	16
2.7 Përafrimi i legjislacionit nga shtetet e rajonit.....	19
2.7.1 Shqipëria .....	19
2.7.2 Mali i Zi .....	21
2.7.3 Serbia .....	22
<b>3. DEKLARIMI I PROBLEMIT</b> .....	24
3.1 Ku është Kosova në plotësimin e këtij kriteri? .....	24
<b>4. METODOLOGJIA</b> .....	27
<b>5. ANALIZA</b> .....	28
5.1 Aspektet krahasimore.....	28
<b>6. KONKLUZIONI</b> .....	30
<b>7. LITERATURA</b> .....	31



## 1. HYRJE

Të fundit u pavarësua e megjithatë jemi populli më i lashtë në rajon. Bëhet fjalë për Kosovën e ashtu quajtur dikur “Dardania” i cili është një shtet i pavarur tashmë në Evropën Juglindore. Pavarësia e saj erdhi nëntë vite pas çlirimit të saj e e kaluara e saj është mjaft e hidhur dhe e dhimbshme pasi që Kosova ishte nën regjimin dhe pushtimin ushtarak serb përgjatë një dekade (1989-1999). Ky shtet i vogël, por me një zemër të madhe i doli ballë këtij regjimi komunist dhe pushtimit Serb me formimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, rreth të cilëve pastaj u bashkua popullata për ta ndal agresionin serb. Forcat serbe kryen krime të rënda ndaj shqiptarëve të Kosovës duke i dëbuar e i dhunuar duke i vrarë e masakruar në mënyrën më çnjerëzore, me një fjalë ata donin të kryenin gjenocid ndaj popullatës shqiptare. Në fund, çlirimi nga forcat serbe erdhi nga ndërhyrja Veriatlantike të shtyrë nga qëllimet humane, aleatët e NATO-së<sup>1</sup> filluan bombardimet dhe sulmet ajrore ndaj Serbisë duke i zbrapsur forcat serbe nga territori i Kosovës.

Republika e Kosovës që nga shtet formimi synon anëtarësimin e saj në NATO, Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe në Bashkimin Evropian.

Në këtë punim do të shtjellohet çështja e plotësimit të njërit prej kriterëve bazë për anëtarësimin në Bashkimin Evropian, pra për përafrimin e legjislacionit vendor me atë të BE-së. Do të diskutohet për procesin e zgjerimit për kriteret e anëtarësimin, do të analizohet përafrimi i legjislacionit në përgjithësi dhe rëndësia e tij, do të diskutohet për legjislacionin e shtetit të Kosovës se në cilën fazë të përafrimit gjendet dhe ku është me plotësimin e këtij kriteri.

Në fund shteti i Kosovës do të krahasohet me shtetet fqinje si Shqipëria, Mali i zi dhe Serbia sa i përket përafrimit të legjislacionit dhe plotësimin e tjera kriterve që si kusht janë për anëtarësimin në BE.

## 2. SHQYRTIMI I LITERATURËS

### 2.1 Procesi i zgjerimit të BE-së: kushtet për anëtarësim

Bashkimi Evropian u krijua në vitet 1950 për të kultivuar paqen, prosperitetin dhe vlerat evropiane në kontinent. Qëllimi i tij është po aq relevant sot sa ishte edhe në atë kohë. (*Anon., 2004*) Ky proces shoqërohet nga politikat e BE-së, po ashtu BE-ja është e hapur për të gjitha shtetet demokratike evropiane që aspirojnë të bëhen pjesë e saj. Zgjerimi shërben për interesat e Shteteve Anëtare si dhe vendeve aderuese. Ai e bën Evropën më të sigurtë dhe vend më të begatë, sidomos përmes promovimit të demokracisë dhe lirive fundamentale, ushtrimit të ligjit dhe tregut të vetëm.

Politika e zgjerimit e BE-së siguron një proces të menaxhuar mirë të anëtarësimit, në mënyrë që zgjerimi të sjellë përfitime të njëkohësishme edhe për BE-në, edhe për vendet që bashkohen. (*EuropeHouse-Kosovo, 2016*) Duke u mbështetur tek Traktati i Mاستrihtit secili shtet anëtarë dhe Parlamenti Evropian duhet të pajtohen për çdo zgjerim. Procesi i zgjerimit ndonjëherë referohet edhe si Integrimi Evropian. Politika e zgjerimit vlen për vendet që aktualisht synojnë të anëtarësohen në BE dhe kandidatët e mundshëm. Perspektiva e anëtarësimit është një stimul i fuqishëm për reforma demokratike dhe ekonomike në vendet që duan të bëhen anëtare të BE-së. (*Comission, n.d.*)

Kandidatët duhet të demonstrojnë se ata do të jenë në gjendje që ta luajnë pjesën e tyre në tërësi si anëtarë - diçka që kërkon përkrahje të gjerë në mesin e qytetarëve, si dhe pajtueshmëri politike dhe teknike me standardet dhe normat e BE-së. Përgjatë procesit, nga aplikimi e deri tek anëtarësimi, BE-ja i aplikon procedurat gjithëpërfshirëse të aprovimit fazë pas fazë. (*Evropian, 2016*)

Procesi i zgjerimit është një proces i gjatë, strikt dhe i komplikuar për shtetet të cilat duan të aderojnë në BE, pasi që ato përballen me negociatat dhe duhet të plotësojnë kritere në mënyrë që të bëhen pjesë e BE-së, duhet thënë se duhet që të jetë një klimë më bashkëpunuese dhe disa

nga këto kritere apo kushte duhet që të jenë më të përshtatshme për anëtarësim, duke mos i vendosur këto vende në situata jo të favorshme.

### **2.1.1 Kushtet për anëtarësimin në BE**

Bashkimi Evropian është bashkimi i 27 vendeve anëtare, i cili është formuar me qëllim të përforcimit të bashkimit politik, ekonomik dhe social. Anëtarësimi kërkon që vendi kandidat të ketë arritur stabilitetin e institucioneve që garantojnë demokracinë, shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut, respektimin dhe mbrojtjen e minoriteteve, ekzistencën e një ekonomie funksionale të tregut si dhe aftësinë për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda Unionit. Traktati mbi Bashkimin Evropian thotë se çdo vend evropian mund të kërkojë anëtarësim nëse respekton vlerat demokratike të BE-së dhe është i përkushtuar për promovimin e tyre. (*comission, 2016*)

Kushti i parë në fakt konsiston në atë se kandidati duhet të jetë shtet, sepse vetëm shtetet mund të paraqesin kërkesën për aderim në Bashkimin Evropian. (*Ujkani, 2012*)

Kushti i dytë konsiston në karakterin gjeografik. Kjo nënkupton se kërkesën për anëtarësim në BE mund ta paraqesin vetëm shtetet evropiane. (*Ujkani, 2012*)

Në vitin 1993, në Këshillin Evropian të Kopenhagës, BE hodhi një hap të rëndësishëm drejt ecjes përpara të procesit të zgjerimit duke deklaruar se “shtetet e asociuara të Europës Qendrore dhe Lindore që dëshirojnë të bëhen Anëtare të BE-se, do të arrijnë të bëhen të tilla.” Në këtë mënyrë, procesi i zgjerimit nuk ishte me një pyetje që kishte të bënte me çështjen “nëse” do të arrinte të bëhej zgjerimi, por “kur” do të kryhej ky proces’. (*Evropian, 2017*) Pra, një vend mund të bëhet anëtar po qe se i plotëson kriteret dhe kushtet e anëtarësimit të cilat janë të definuara nga lideret e BE-së gjatë samitit, i cili është mbajtur më vitin 1993 në Kopenhagë.

Kriteret e Kopenhagës i referohen kriterëve të përgjithshme që vendet aplikuese duhet të plotësojnë si parakusht për t'u bërë anëtare të Bashkimit Evropian u përcaktuan në terma të përgjithshëm nga Këshilli Evropian i Kopenhagës në qershor 1993. (*OECD, 2013*) Kriteret e Kopenhagës kërkojnë: stabilitetin e institucioneve që garantojnë demokracinë, shtetin e së

drejtës, të drejtat e njeriut dhe respektimin dhe mbrojtjen e minoriteteve; ekzistenca e një ekonomie funksionale të tregut, si dhe aftësia për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda BE-së; dhe aftësinë për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit, përfshirë aderimin në qëllimet e bashkimit politik, si dhe të Unionit Ekonomik dhe Monetar (EMU). (OECD, 2013)

Kriteret të cilat janë definuar nga Këshilli Evropian në Kopenhagë në vitin 1993 dhe të cilat kritere më pas zbatohen në vitin 1995 janë:

1. Kriteri politik: institucione stabile që garantojnë demokracinë, sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut dhe respektimin dhe mbrojtjen e pakicave.
2. Kriteri ekonomik: ekonomi funksionale e tregut dhe kapaciteti për të përballuar konkurrencën dhe fuqitë e tregut në UE.
3. Kapaciteti i pranimit të obligimeve të anëtarësimit, përfshirë këtu edhe mbështetjen e synimeve të unionit politik, ekonomik dhe monetar.
4. Miratimi i një organizmi të tërë legjislativ evropian dhe implementimi i efektshëm i këtij legjislacioni me anë të strukturave të duhura administrative dhe juridike. (Evropian, 2016)

Përfundimisht aderimi në BE është i kushtëzuar me respektimin e Acquis communautaire të Bashkimit Evropian. (Ujkani, 2012)

Be-ja është kompetente të integrojë anëtarë të rinj për këtë arsye përmban edhe të drejtën e vendosjes së periudhës së pranimit të tyre. Shtetet anëtare të BE-së me pëlqim unanim vendosin për pranimin e një shtet anëtari të ri.

Kur një vend aplikon për anëtarësim në BE, qeveritë e Shteteve Anëtare, të përfaqësuara në Këshill, së pari vendosin nëse do të pranojnë apo jo aplikimin. Shtetet Anëtare pastaj vendosin, në bazë të opinionit nga Komisioni Evropian, nëse shtetit që aplikon do t'i japin apo jo statusin e kandidatit si dhe vendosin për t'i filluar bisedimet e anëtarësimit. (Evropian, 2016) Parlamenti Evropian, deputetët e të cilit zgjidhen drejtpërdrejtë nga qytetarët e BE-së, gjithashtu duhet dhënë pëlqimin e vet. Pastaj, traktati duhet të ratifikohet nga të gjitha Shtetet Anëtare dhe vendi aderues, në pajtim me procedurat e tyre të themeluara kushtetuese.

## 2.2 Përafrimi i legjislacionit si kusht për anëtarësimin në BE

Është një detyrim unik i anëtarësimit në Bashkimin Europian, për shtetet të cilat duan të aderojnë apo t'i bashkohen atij që të përafrojnë ligjet, procedurat dhe rregullat e tyre kombëtare në mënyrë që të japin efekt sa i përket organit të ligjit të BE-së, përfshirë dhe atë të Acquis Communautaire. Direktivat, rregulloret dhe vendimet e miratuara në bazë të Traktateve të ndryshme të BE-së janë të përfshira në Acquis Communautaire, të cilat Traktate së bashku përbëjnë ligjin parësor të BE-së.

Ekzistojnë tre elemente kryesore për përafrimin e legjislacionit vendor me atë të BE-së:

Së pari, të miratohen ose ndryshohen ligjet, rregullat dhe procedurat kombëtare në mënyrë që kërkesat e ligjit përkatës të BE-së të përfshihen plotësisht në rendin ligjor kombëtar.

Ky proces njihet si Transportim. Megjithëse, vendet kanë diskrecion të konsiderueshëm në zgjedhjen e mekanizmit më të përshtatshëm kombëtar për të reflektuar detyrimet mjedisore të Unionit, ky diskrecion është i kufizuar në disa aspekte nga parimet e përgjithshme të ligjit të Unionit. Në shumicën e rasteve do të jetë e nevojshme të miratohet legjislacioni kombëtar i miratuar nga Parlamenti ose në disa vende me Dekret Presidencial ose Qeveritar. (*Europe, 2019*)

Së dyti, të sigurohen institucionet dhe buxhetet e nevojshme për zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve (i njohur si 'Zbatimi' ose 'Zbatimi Praktik' i direktivës). (*Europe, 2019*)

Së treti, të sigurohen kontrollet dhe gjodat e nevojshme për të siguruar që ligji po zbatohet plotësisht dhe në mënyrë të duhur (Zbatimi). (*Europe, 2019*)

Duke e patur parasysh që përafrimi është një proces tejet i vështirë, legjislacioni ekzistues i vendeve të cilat kanë aplikuar apo duan të jenë shtete anëtare është shumë i ndryshëm nga legjislacioni ekzistues i BE-së, prandaj standardet midis këtyre shteteve dhe BE-së ndryshojnë shumë, dhe rregullimi i mjedisit (*OSCE, 2008*) nga BE-ja mbulon një fushë më të gjerë çështjesh. Dështimi më i madh i shteteve aplikuese që ato të anëtarësohen në Union ndodh atëherë, kur ato kanë dështuar të përafrojnë siç duhet legjislacionin e tyre mjedisor, duke u përqendruar më shumë në çështje ekonomike. Prandaj, përafrimi sa më i suksesshëm është më se i nevojshëm që këto shtete të mund të bëhen pjesë e BE-së.

Në Bashkimin Evropian, koncepti i përafrimit të ligjit do të thotë procesi i harmonizimit të legjislacionit kombëtar me të drejtën e BE-së. (*Kryeministrit, 2018*) Prosesi i përafrimit përfshin metoda dhe teknika për të transpozuar legjislacionin e BE-së në të drejtën kombëtare, përfshirjen e saj në sistemet ligjore kombëtare dhe procesin e implementimit, e që individualisht, manifestohet përmes realizimit të të drejtave individuale ose supozimit të obligimeve konkrete (*Kryeministrit, 2018*).

Në pajtueshmëri me Nenin 4 të Traktatit të Bashkimit Evropian, Shtetet Anëtare të BE-së do të ndërmarrin çfarëdo mase të përshtatshme, në përgjithësi ose të veçantë, për të siguruar plotësimin e obligimeve që dalin nga Traktatet ose që rrjedhin nga aktet e institucioneve të BE-së. Gjithashtu, ato duhet të ndihmojnë edhe arritjen e detyrimeve të BE-së dhe të përmbahen nga çfarëdo mase, që do të mund të rrezikonte arritjen e objektivave të BE-së. (*Kryeministrit, 2018*)

Përafrimi i legjislacionit vendor me atë *acquis* të BE-së ka rëndësi të madhe pasi që është edhe njëri prej kushteve për shtetet të cilat kanë synim aderimin në BE.

### 2.3. Përafrimi i legjislacionit dhe Kosova

Në mënyrë që një vend të bëhet anëtar i Bashkimit Evropian, ai duhet të plotësojë kriteret e antarësimit. Këto kushte u vunë në një takim në Kopenhagen në vitin 1993 dhe për pasojë u referohen si “Kriteret e Kopenhagenit” (*Europe, 2019*). Këto kritere u referohen shteteve të cilat pretendojnë të jenë shtete anëtare të BE-së, kritere të cilat janë të natyrës politike, ligjore dhe ekonomike. Kështu që, pretendimet e Republikës së Kosovës për t’u anëtarësuar në BE, përpos që kanë të bëjnë me çështje politike dhe ekonomike kanë të bëjnë më shumë me çështje ligjore.

Një ndër shtyllat kryesore që e shpiejnë Kosovën drejt integritimit Evropian është përafrimi i legjislacionit vendor me atë të BE-së (acquis), kështu që, në kuadër të kësaj, institucionet e Republikës së Kosovës kanë ndërtuar infrastrukturën ligjore që kanë për qëllim përafrimin e legjislacionit vendor me atë të BE-së.

Rruga drejt realizimit drejt të përafrimit të legjislacionit të BE-së në Kosovë, duhet të përfshijë një spektër më të gjerë të aktiviteteve si dhe angazhimin e institucioneve shtetërore që kanë të bëjnë me planifikimin, miratimin, draftimin dhe zbatimin e legjislacionit vendor në përputhje me atë të BE-së. Në kuadër të këtij procesi, ajo që më së miri i ndihmon institucionet dhe akterët pjesmarrës është, përkthimi i acquis të BE-së në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, në mënyrë që aktet ligjore të vendit me ato të BE-së të kenë një përafrim sa më korrekt.

Autoriteti kyç në ofrimin e mbështetjes profesionale dhe ligjore për strukturat institucionale të Republikës së Kosovës, në fushën e përcaktimit të legjislacionit vendor me acquis të BE-së është departamenti i së drejtës së BE-së i Ministrisë së Integritimit Evropian.

Pa dyshim që procesi për përafrim të legjislacionit është një proces tejet i vështirë dhe sfidues për institucionet e Republikës së Kosovës, e megjithatë ky proces është kriter për antarësimin në BE.

## 2.4 Hyrje e përgjithshme

Është në interesin kombëtar të Kosovës që, Republika e Kosovës të përqëndrohet në afrimin me BE, dhe rruga më e mirë për ndërtimin e një shteti modern bëhet përmes respektimit të rregullave të cilat janë përcaktuar nga BE-ja, po ashtu duke e marrë parasysh që Republika e Kosovës është shteti më i ri në rajon dhe shteti i vetëm i cili nuk ka marrëdhënie kontraktuale me BE-në, angazhimi i saj për ndërtimin dhe forcimin e institucioneve shtetërore, sigurimin e rritjes ekonomike si dhe rregullimin e mjedisit do e lehtësonte rrugën drejt përafrimit të legjislacionit.

Kosova është në rrugë të mbarë drejt Bashkimit Evropian. Këtë më së miri e kuptojmë nga sinjalet e qarta që BE-ja dhe shtetet anëtare të saj po e japin për synimin e tyre, që të forcojnë marrëdhëniet me Republikën e Kosovës. Kosova po përgatitet që të hyjë në një fazë të re të marrëdhënieve të veta me BE-në. Populli dhe institucionet e saj janë të përkushtuar plotësisht ndaj procesit të integritimit Evropian dhe me synim anëtarësimin në BE.

Edhe pse nuk ekziston një marrëdhënie kontraktuale midis Kosovës dhe BE-së, Kosova përsëri merr pjesë në partneritetin Evropian. Pas dialogut të vazhdueshëm në mes BE-së dhe Kosovës përmes Mekanizmit Përcjellës të Stabilizimit Asocijimit (MPSA), në gusht të vitit 2006, është aprovuar Plani i Veprimit për Implementimin e Partneritetit Evropian (PVIPE) (*Zyra e Unmikut per integrime Evropiane, 2006*) Ky plan ka për qëllim që të bëhet korniza e masave të cilat kur implementohen sigurojnë një përparim nëagjenden e integritimit Evropian. Në mënyrë që kushtet për anëtarësim të plotësohen sa më shpejt që është e mundur duhet të ndërmerren prioritetet afat shkurta dhe afat mesme që ky plan përmban.

Një progres mjaftë irëndësishëm shihet qartë nga Kosova që po e bënë duke nxjerr ligje të reja në përputhshmëri me legjislacionin e BE-së. Kështu që, janë krijuar institucione përgjegjëse si dhe janë paraparë procedura ligjore për këtë proces. Por, sa do të kenë kapacitet të mjaftueshme këto institucione që të zbatojnë njëproces të tillë me një rëndësi kaq të veçantë mbetet të shihet.



## 2.5 Bashkëpunimi BE-Kosovë në përafrim të legjislacionit

12 vite pas shpalljes së pavarësisë dhe marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe BE-së nuk kanë përparuar edhe aq sa duhet, ato kanë ecur me një ritëm të ngadalshëm. Kosova ka marrëdhënie formale me BE-në, ajo vazhdon të merr pjesë në dialogun për procesin e Stabilizim-Asociimit dhe deri më tani ka raportuar për përparimin e shënuar në procesin e integritimit evropian. (*Kosoves-Presidenti, 2020*) Procesi i Stabilizim-Asociimit ka tre qëllime: stabilizimin dhe tranzicionin e shpejtë në ekonominë e tregut, promovimin e bashkëpunimit rajonal dhe perspektivën për anëtarësimin në BE. (*Europa, n.d.*)

Kosova është pjesë e Kornizës së Procesit për Stabilizim-Asociim(PSA) që nga Samiti i Selanikut. (*Kosoves, 2017*) Veçanërisht, në prill të vitit 2005, Komisioni Evropian (KE) publikoi komunikatën "Një e ardhme Evropiane për Kosovën", kurse në 2006-ën Këshilli aprovoi partneritetin e parë Evropian me Kosovën. (*Kosoves, 2017*) Në përgjigje të partneritetit Evropian, Qeveria miratoi Partneritetin e parë Evropian Plani i Veprimit (PVPE) në vitin 2008, i cili u rishikua çdo fund të vitit, pas Botimit të Raportit të Progresit. (*Kosoves, 2017*)

Marrëdhënia e parë kontraktuale dhe po ashtu një hap shumë i rëndësishëm për Kosovën në rrugën e saj drejt BE-së është Marrëveshja për Stabilizim dhe Asociim(MSA) ndërmjet Kosovës dhe BE-së e cila hyri në fuqi në prill të vitit 2016. Kjo marrëveshje nuk është vetëm një dokument i lartë politik. Përmes kësaj marrëveshjeje është dakorduar një proces për mbështetje reale të reformave, i cili do të ndikojë në mundësitë dhe jetën e qytetarëve. (*CENTRE, n.d.*) Zbatimi gradual i MSA duhet të bëjë edhe ndryshime në cilësinë e jetesës, duke e bërë përmisimin e kushteve të të drejtave të njeriut, forcimin e sistemit gjyqësor, forcimin e institucioneve demokratike, qasje nëpër tregjet Evropiane, përmisim në cilësinë e prodhimeve të Kosovës kështu që, ato do të jenë më tërheqëse për konsumatorët gjithandej tregut të BE-së përmes përafrimit të legjislacionit vendor me acquis të BE-së dhe zbatimin e tij. (*Kosoves, 2017*) Marrëveshja për Stabilizim dhe Asociim si një kornizë detyruese kontraktuale e Kosovës, marrëdhëniet me BE-në përcaktojnë detyrime specifike që Kosova duhet t'i përmbushë me qëllim ndaj hyrjes në BE. (*Kosoves, 2017*) Këto detyrime do të përmbusheshin përmes

angazhimit në një përafrim sa më adekuat të legjislacionit me atë të BE-së poashtu edhe me zbatimin e tij dhe ky përafrim duhet të ndodhë në afate të caktuara kohore.

Be-ja është shembulli më i madh dhe më i mirë i bashkëpunimit. Prandaj, në mënyrë që të bëhesh shtet anëtarë i plotë i BE-së duhet të përmbushim kushtin për bashkëpunim të mirëfilltë me BE-në, gjithashtu paraqitet edhe në MSA, si një vlerë thelbësore Evropiane për të adresuar bashkërisht sfidat e përbashkëta. Është fakt që rruga drejt Bashkimit Evropian është proces i gjatë dhe transformues, dhe ky proces nuk do të mund të arrihet nga cili do institucion që punon i vetëm. Përkundrazi ky proces përfshinë të gjitha institucionet, partitë dhe të gjitha pjesët e shoqërisë.

Sipas tre kriterve të Kopenhagës, Kosova ka marrë përsipër detyrimin që gradualisht, brenda një periudhe dhjetë vjeçare të zbatimit të MSA-së, të arrijë standardet e BE-së në të gjitha fushat e qeverisjes.

## **2.6 Mekanizmat shtetëror të Republikës së Kosovës për përafrim të legjislacionit**

Procesi i përafrimit të legjislacionit të Republikës së Kosovës me atë të BE-së kërkon një përkushtim të posatshëm gjithpërfshirës të të gjithë mekanizmave shtetërore. Shteti i Kosovës me seriozitet të theksuar synon rrugën drejt BE-së dhe për këtë arsye ka treguar një gatishmëri të lartë në harmonizimin e legjislacionit vendor me atë Evropian.

Ky proces po që është shumë i ndërlikuar dhe sfidues, e megjithatë Qeveria e Kosovës është duke i ndërmarrë masat e nevojshme dhe është e përkushtuar që t'i përdorë të gjitha mekanizmat e saj që hap pas hapi, të mundohet të përafrojë legjislacionin e Republikës së Kosovës në mënyrë sa më të përshtatshme që të mund të jetë në përputhje me atë të BE-së.

Ky proces pasi që është tejet i vështirë dhe duhet shumë punë që sa më mirë të realizohet përafrimi i tij, kërkon burime njerëzore profesionale me një ekspertizë të mjaftueshme si dhe struktura të mirë vendosura. Me miratimin dhe hyrjen në fuqi të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovë nr. 09/2011, Rregullores nr. 13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar (17/06/2013) dhe të Udhëzimit Administrativ nr. 03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative (17/06/2013), janë themeluar strukturat dhe se janë vendosur proceset e përafrimit të legjislacionit. (Kosoves, 2014) Këto kërkesa janë strukturuar me qëllim të draftimit të akteve ligjore në përputhshmëri të plotë me kërkesat dhe standardet e acquis të BE-së, kështu që, përpiluesit e legjislacionit gjatë procesit të hartimit të këtyre akteve u përmbahen kërkesave dhe kriterve normative të cilat rrjedhin nga këto akte ligjore.

Në vazhdim do të shqyrtohen disa nga mekanizmat shtetërore që luajnë një rol vendimtar për sa i përket çështjeve të përafrimit ligjor, por jo vetëm.

## **2.6.1 Komisioni Parlamentar për integrim Evropian**

Komisioni Parlamentar për Integrim Evropian rishikon brenda zonave të përgjegjësisë projektligjet dhe çështjet e tjera që paraqiten në Kuvend, ndjek zbatimin e ligjeve dhe rregullon veprimtarinë e ministrive dhe të organeve të tjera shtetërore, kryen studime për efektivitetin e ligjeve në fuqi, sugjeron për miratim në Kuvend projektligje, si dhe i propozon Kuvendit marrjen e masave përkatëse për përafrim të legjislacionit.

Në bazë të shtojcës Nr.2 të rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, puna e komisionit për Integritime Evropiane është e strukturuar si në vijim:

Komisioni për Integritime Evropiane është komision i përhershëm. Komisioni, në kuadër të fushëveprimit dhe të përgjegjësisë, e shqyrton dhe e mbikëqyr procesin e harmonizimit të çdo ligji të miratuar në Kuvend, me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Fushëveprimi i këtij Komisioni, përfshinë:

- Mbikëqyrjen e procesit të harmonizimit të sistemit juridik të Kosovës me sistemin juridik të Bashkimit Evropian,
- Mbikëqyrjen e procesit të harmonizimit të legjislacionit me *acquis communautaire*.
- Shqyrtimin e projektligjeve të iniciuara për miratim nga Kuvendi, nga aspekti i përafrimit dhe i përputhshmërisë së legjislacionit me *acquis communautaire*.
- Bashkëpunimin dhe koordinimin e punëve me institucionet e Bashkimit Evropian në drejtim të integritetit dhe të anëtarësimit të Kosovës në Bashkimin Evropian,
- Bashkëpunimin dhe shkëmbimin e përvojave me shtetet e BE-së dhe me shtetet e tjera për integrim në BE,
  
- Bashkëpunimin dhe koordinimin e punëve me institucionet evropiane në Kosovë:
  - a. Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian,
  - b. Zyra Ndërkombëtare Civile (Përfaqësuesi Special i BE-së në Kosovë),
  - c. Misioni EULEX në Kosovë,
  - d. Agjencia Evropiane për Rindërtim,
  - e. Kryesia e BE-së,
  - f. Misioni BE-së për mbikëqyrje,
  
- Mbikëqyrjen e punës së Qeverisë në përmbushjen e detyrimeve të marra nga institucionet e Kosovës dhe sidomos detyrimet e Kuvendit ndaj institucioneve të Bashkimit Evropian,
- Mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të Veprimit për Partneritet Evropian (PVPE),
- Participimin dhe mbikëqyrjen e Procesit të Stabilizimit dhe të Asociimit të Kosovës,
- Mbikëqyrjen dhe koordinimin e procesit të ashtuquajtur “Pre-accession Assistance (IPA)”,

- Monitorimin e programit të donatorëve dhe të kooperimit të BE-së, të dedikuara për Kosovën,
- Bashkëpunimin me institucionet përkatëse në procesin e anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës,
- Mbikëqyrjen e zbatimit të detyrave të Kosovës, të dala nga konventat e Këshillit të Evropës,
- Mbikëqyrjen e zbatimit të rekomandimeve të Këshillit të Evropës për Kosovën,
- Shqyrtimin e çështjeve të tjera të përcaktuara me këtë Rregullore dhe çështjet të cilat, me vendim të veçantë të Kuvendit, i barten këtij Komisioni;

Për ushtrimin e funksioneve, Komisioni bashkëpunon me Zyrën e Kryeministrit - resorin përkatës dhe me të gjitha ministratë e tjera, nga të cilat mund të kërkojë të dhëna konkrete, duke i përfshirë këtu edhe raportet e drejtpërdrejta të ministrave ose të personave të tjerë përgjegjës, kur kjo kërkohet nga Komisioni. (*Kosovo, 2010*)

## **2.6.2 Departamenti i së drejtes së BE-së në kuader të ministrisë së Integritimit Evropian**

Në kuadër të Ministrive të shtetit të Kosovës ekzistojnë departamente që kanë për qëllim përafrimin ligjor me *acquis*. Ministria e Integritimit Evropian luan rol primar në koordinimin e politikave evropiane duke ofruar mbështetje ligjore strukturave tjera të ministrisë në procesin e integritimit evropian.

Departamenti i së drejtës së BE-së përmbanë dy divizione të veçanta për përafrim të legjislacionit dhe këto divizione janë si vijon:

### Divizioni i Çështjeve Ligjore të BE-së

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit të Çështjeve Ligjore të BE-së janë:

1.1. Ofron mbështetje për procesin e vlerësimit të pajtueshmërisë së legjislacionit vendor me Acquis communautaire;

1.2. Ofron mbështetje ligjore MIE-së, ministrivetë linjës dhe ekipit negociues për negociimin, zbatimin dhe interpretimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit;

1.3. Ofron mbështetje ligjore MIE-së, ministrivetë linjës dhe ekipit negociues gjatë negociatave për antarësim në BE;

1.4.

Ofron mbështetje ligjore për të gjithë ministrivetë gjatë përgatitjes së prioriteteve për Strategjinë Legjislative, duke u bazuar në Planin e Veprimit për Partneritetin Evropian, *Raportin* vjetor të Progresit të Komisionit Evropian, MSA, etj;

1.5. Ofron mbështetje ligjore në procesin e shpërndarjes së Acquis communautaire gjatë përgatitjes së PVPE-së, dhe mirëmban bazën përkatëse të të dhënave;

1.6. Ofron këshilla ligjore rreth interpretimit dhe zbatimit të legjislacionit të BE-së për institucionet e Republikës së Kosovës, sipas kërkesës;

1.7. Bashkëpunon me Komisionin për Integrim Evropian në Kuvendin e Kosovës për përafrimin dhe harmonizimin e legjislacionit.

2. Udhëheqësi i Divizionit të Çështjeve Ligjore të BE-së raporton tek Udhëheqësi i Departamentit.

3. Numri i të punësuarve në kuadër të Divizionit të Çështjeve Ligjore të BE-së është katër (4).

#### Divizioni i Përkthimit dhe Terminologjisë së Acquis Communautaire

1. Detyrat dhe Përgjegjësitë e Divizionit të Përkthimit dhe Terminologjisë së Acquis communautaire janë:

1.1. Menaxhon dhe koordinon procesin e përkthimit të Acquis Communautaire;

1.2. Menaxhon dhe koordinon procesin e ekspertizës ligjore dhe rishikimin e legjislacionit të përkthyer të Bashkimit Evropian;

1.3. Siguron unifikimin e procedurave që lidhen me procesin e përkthimit të Acquis Communautaire;

1.4. Mirëmban bazën e të dhënave për terminologjinë dhe monitorimin e të dhënave për procesin e përkthimit të Acquis Communautaire;

1.5. Ofron mbështetje në krijimin e metodologjisë për përdorimin e terminologjisë së unifikuar gjatë përgatitjes së legjislacionit kombëtar;

1.6. Bashkëpunon me institucionet e BE-së dhe me institucionet tjera vendore dhe ndërkombëtare të përfshira në procesin e përgatitjes së versionit kombëtar të Acquis Communautaire.

2. Udhëheqësi i Divizionit të Përkthimit dhe Terminologjisë së Acquis Communautaire raporton tek Udhëheqësi i Departamentit. *(Evropiane, 2017)*

## 2.7 Përafrimi i legjislacionit nga shtetet e rajonit

### 2.7.1 Shqipëria

Bashkimi Europian mori zotimin për t'u zgjeruar në Ballkanin Perëndimor në Samitin e Selanikut në Qershor të 2003-ës, ku Shqipëria, së bashku me vendet e tjera të rajonit u identifikuan si vendet candidate potenciale për anëtarësim. (*policy, 2017*) Rruga e Integritit Europian e nisur në korrik 1991, kohë në të cilën u vendosën marrëdhëniet diplomatike mes BE-së dhe Shqipërisë, ka kaluar në disa etapa të rëndësishme ndër të cilat mund të përmenden nënshkrimi i Marrëveshjes së Tregëtisë dhe Bashkëpunimit në 1992, çelja e negociatave dhe nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) respektivisht në 1999 dhe 2006, liberalizimi i regjimit të vizave në 2010 dhe marrja e statusit të vendit kandidat në 2014. (*center, 2020*)

Shqipëria ka ende shumë sfida për të arritur drejt rrugës së Integritit Evropian ku më e përafërta prej tyre është çelja e negociatave për anëtarësimin në BE. Për Shqipërinë, hapja e negociatave kushtëzohet me ecurinë e mëtejshme të reformës në drejtësi, sidomos procesit të vetting-ut. (*Monitor, 2018*)

Në vendet të cilat janë në fazën e para-aderimit në BE, sikurse është Shqipëria, përputhja e të drejtës së brendshme me *acquis*-në e BE-së është një tjetër qëllim që duhet të mbahet parasysh. (*Drejtësi, 2010*) Detyrimi i Republikës së Shqipërisë për përafrimin e legjislacionit të saj me *acquis* të BE-së buron nga Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit BE-Shqipëri, e cila është nënshkruar më 12 qershor 2006 dhe ka hyrë në fuqi më 1 prill 2009.

Në tetor të vitit 2012, Komisioni Evropian rekomandoi që Shqipërisë t'i jepej statusi i vendit kandidat, me kusht plotësimin e masave kyçe që kishin të bënin me reformën në drejtësi, administratën publike, si dhe rishikimin e rregulloreve parlamentare. Në qershor të vitit 2014, Shqipërisë iu dha statusi i vendit kandidat dhe aktualisht është në pritje të hapjes së bisedimeve për anëtarësim. (*network, 2016*) Vendimi për hapjen e bisedimeve për anëtarësim, merret atëherë kur BE-ja vlerëson se vendi kandidat ka plotësuar kriteret politike dhe ekonomike, pra, është një



demokraci funksionale dhe një ekonomi e lirë e tregut. (*network, 2016*) Bisedimet për anëtarësim janë të rëndësishme, pasi ato jo vetëm ndihmojnë vendin kandidat për përmbushjen e detyrimeve të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, por i krijojnë mundësi edhe BE-së të përgatitet për zgjerimin e radhës. (*network, 2016*)

Sipas Raportit të Progresit të vitit 2018 (*commission, 2018*) Shqipëria ka vazhduar të zbatojë Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit dhe u zhvilluan takime të organeve të përbashkëta sipas marrëveshjes. Në Nëntor 2016, Komisioni rekomandoi hapjen e negociatave të pranimit subjekt të besueshëm dhe progres i prekshëm në zbatimin e reformës në drejtësi, në veçanti rivlerësimi i gjyqtarët dhe prokurorët (*vetting*). Komisioni ka vazhduar të monitorojë plotësisht zhvillimet në kontekstin e pesë prioritetëve kryesore.

Sipas Raport progresit të vitit 2019 (*commission, 2019*) Shqipëria ka vazhduar të zbatojë Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit dhe u zhvilluan takime të organeve të përbashkëta sipas marrëveshjes. Në Prill 2018, Komisioni rekomandoi që Këshilli të vendos që negociatat e pranimit të hapen me Shqipërinë, në të njëjtën kohë duke inkurajuar Shqipërinë të ruajë dhe të thellojë momentin aktual të reformës, veçanërisht në fushën kryesore të sundimit të ligjit. Në qershor 2018, Këshilli parashtrroi rrugën drejt hapja e negociatave të pranimit në qershor 2019. Shqipëria ka vazhduar të zbatojë reformat që janë thelbësore për agjendën e BE-së, veçanërisht duke dhënë rezultate konkrete në kushte të identifikuar në Konkluzionet e Këshillit të Qershorit 2018 për hapjen e negociatave të pranimit. Komisioni ka vazhduar të monitorojë plotësisht zhvillimet në këto fusha.

## 2.7.2 Mali i Zi

Një Marrëveshje e Stabilizim Asociimit është krijuar midis Malit të Zi dhe Bashkimit Evropian që nga viti 2010, dhe në qershor 2012-ës vendi hyri në negociatat e pranimit me BE.

Sipas kushteve të Marrëveshjes së Asociimit dhe për të përmbushur kërkesat për anëtarësim, legjislacioni i Malit të Zi duhet të harmonizohet me legjislacionin e BE-së. (Economy, 2016)

Mali i Zi filloi procesin për Integrimin Evropian në vitin 2005. Kërkesa e Malit të Zi për anëtarësim në BE u paraqit në 15 dhjetor 2008. Në mbledhjen e tij në 23 Prill 2009, Këshilli ftoi Komisionin t'i paraqesë Këshillit mendimin e tij mbi kërkesën e Malit të Zi. Komisioni dha një mendim pozitiv më 12 tetor 2011 dhe rekomandoi hapjen e negociatave të pranimit. Në mbledhjen e tij në 16-17 dhjetor 2010, Këshilli Evropian ra dakord t'i jepte statusin e vendit kandidat Malit të Zi. (*Council, 2010*)

MSA është një traktat ndërkombëtar midis një shteti nënshkrues dhe Bashkimit Evropian që krijon një kornizë ligjore për bashkëpunim të ndërsjellë dhe një përafrim gradual me standardet evropiane. Hyrja në fuqi e MSA shënon hyrjen në një fazë të re të integritit, e cila tani zyrtarisht e angazhon Malin e Zi të përafrojë legjislacionin e tij me *acquis communautaire*, si dhe të përafrojë pikëpamjet dhe politikat e tij në të gjitha fushat e bashkëpunimit. Cilësia e zbatimit të MSA-së do të jetë një nga kriteret për marrjen e një mendimi pozitiv të KE-së, si dhe për marrjen e statusit të kandidatit, hapjen e negociatave dhe për dinamikën e procesit të pranimit në BE. (*integracije, n.d.*)

Sipas Raportit të Progresit të vitit 2018 (*commission, 2018*) Bisedimet e pranimit me Malin e Zi filluan në qershor 2012. Deri më tani, janë hapur 30 kapitujt e bisedimeve, tri prej të cilave janë mbyllur përkohësisht. Në qershor 2017, Mali i Zi u bë anëtar i NATO-së. Mali i Zi vazhdoi të zbatojë përgjithësisht Marrëveshjen për dhe mbledhjet e organeve të përbashkëta nën këtë marrëveshje u mbajtën rregullisht dinamika. Gjashtë kapitujt negociues u hapën gjatë periudhës së raportimit, dhe një është i mbyllur përkohësisht. Konferencat e pjesëmarrjes ishin gjithashtu të mundshme për shkak të përparimit që është bërë i realizuar në fushën e sundimit të ligjit dhe në kushtet e përcaktuara në negociata. Progres drejt arritjes së standardeve të përcaktuara në kapitujt në fjalë përafrimi i ligjit do të jetë thelbësor për përparimin e negociatave të pranimit.

Sipas Raportit të Progresit të vitit 2019 (*Commission, 2019*) bisedimet e pranimit me Malin e Zi filluan në qershor 2012. Edhe sot e kësaj dite janë të hapur 32 kapituj negociues, tre prej të cilëve u mbyllën përkohësisht. Mali i Zi vazhdoi të zbatojë kryesisht Marrëveshjen e Stabilizim-Zgjerimit (MSA), e takimet e organeve të përbashkëta nën këtë Traktat do të mbahen rregullisht. Gjatë periudhës së raportimit, u hapën dy kapituj negociues, pa kapituj mbyllur përkohësisht. Konferencat e aksesit ofrojnë gjithashtu përparimin e bërë në fushën e sundimit të ligjit, në përputhje me kushtet e negociatave. Përparimi drejt përmbushjes së standardeve kalimtare të përcaktuara në kapitujt përkatës, sundimi i ligjit 23 dhe 24 do të jetë thelbësor për përparimin e mëtutjeshëm të të gjithë procesit të bisedimeve.

### **2.7.3 Serbia**

Republika e Serbisë mori detyrimin për të harmonizuar legjislacionin e saj me ligjin e BE-së me akt të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA), një akt "me rëndësi të madhe" (*Stancic, 2002*) për çdo shtet anëtar potencial të BE-së. Edhe nëse është e qartë se shkalla e përafrimit të standardeve ligjore vendase me ligjin e BE-së është një element i rëndësishëm në negociatat me BE-në, proceset e harmonizimit dhe negociatave janë të ndryshme në aspektin juridik, politik dhe metodologjik. Për më tepër, zakonisht është rënë dakord në teori se "Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian nuk parashikon harmonizimin juridik si një detyrë në vetvete" (*Wilhelmsson, 2004*) ndërsa "rezultati i negociatave të pranimit në BE është shumë i rëndësishëm për një aspirant shteti anëtar". (*Bjarnason, 2010*)

Në fund të vitit 2011, Serbia do të arrijë një moment historik në të vërtetë për t'u aderuar në Bashkimin Evropian (BE). Pas publikimit të mendimit të Komisionit Evropian për gjendjen e gatishmërisë së Serbisë për pranimin në BE, Këshilli Evropian mund të vendosë t'i japë statusin e vendit kandidat Serbisë dhe gjithashtu të hapë anëtarësimin negociatave. (*Serbia, 2011*)

Serbia së bashku me pesë vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor - u identifikua si një kandidat i mundshëm për anëtarësim në BE gjatë samitit të Këshillit Evropian të Selanikut në 2003. Në vitin 2008, u miratua një partneritet evropian për Serbinë, duke përcaktuar përparësitë për aplikimin e anëtarësimin të vendit, dhe në 2009 Serbia aplikoi zyrtarisht. Në Mars 2012

Serbisë iu dha statusi i kandidatit të BE-së. Në Shtator 2013 hyri në fuqi një Marrëveshje e Stabilizim Asociimit Kërkimi për përkthime të disponueshme të lidhjes paraprake ndërmjet BE-së dhe Serbisë. (*Comission, 2019*)

Sipas Raportit të Progresit të vitit 2018 (*Comission, 2018*) Që prej fillimit të negociatave të pranimit të Serbisë në janar 2014, 12 nga 35 kapitujt janë hapur, dy prej të cilave janë mbyllur përkohësisht. Ritmi i përgjithshëm i negociatave do vazhdojnë të varet nga përparimi i Serbisë në reforma dhe veçanërisht në një ritëm më të fortë të reformat mbi sundimin e ligjit dhe në normalizimin e marrëdhënieve të saj me Kosovën. Këshilli Evropian i dha Serbisë statusin e vendit kandidat në 2012. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) midis Serbisë dhe BE-së hyri në fuqi në shtator 2013. Serbia vazhdoi të zbatojë MSA-në, megjithëse një numër i ri në çështjet e pajtueshmërisë janë shfaqur gjatë vitit të kaluar.

Sipas Raportit të Progresit të vitit 2019 (*Comission, 2019*) Këshilli Evropian i dha Serbisë statusin e vendit kandidat në 2012. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) midis Serbisë dhe BE hyri në fuqi në shtator 2013. Takimet e organeve të përbashkëta sipas marrëveshjes u mbajtën rregullisht intervale. Serbia vazhdoi të zbatojë MSA-në, megjithëse një numër çështjesh pajtueshmërie mbeten. Që nga fillimi i negociatave të pranimit të Serbisë në janar 2014, 16 nga 35 kapitujt janë hapur, dy prej të cilave janë mbyllur përkohësisht. Katër kapituj u hapën gjatë periudha e raportimit. Ritmi i përgjithshëm i negociatave do të vazhdojë të varet në veçanti një ritëm më intensiv i reformave mbi sundimin e ligjit dhe në normalizimin e marrëdhënieve të tij me Kosovën sipas kërkesave të Kornizës së Negociatave.

### 3. DEKLARIMI I PROBLEMIT

#### 3.1 Ku është Kosova në plotësimin e këtij kriteri?

Kosova has në shumë sfida e barierra drejt rrugës së integritit Evropian, proces i cili është synim dhe prioritet kryesor kombëtar i Republikës së Kosovës që nga momenti i formimit të shtetësisë.

Shteti i Kosovës ende nuk e ka statusin e vendit kandidat e megjithatë BE-ja ka një numër kërkesash specifike, ndër të cilat ajo për avancimin e dialogut me Sërbinë si dhe kërkesa për avancimin e sundimit të rendit dhe ligjit.

Në prill të vitit 2016 ka hyrë në fuqi Marrëveshja për Stabilizim dhe Asociim, marrëveshje e cila shënon një hap të madh për Kosovën duke krijuar kështu marrëdhënien e parë kontraktuale me BE-në. Me hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje, Kosova përmbyll një proces të gjatë dhe jo të lehtë në ndërtimin e raporteve kontraktuale me BE-në, ia hap vetes mundësitë e mëdha për qasje në tregun e BE-së, përfiton nga mundësitë e shumta që krijon kjo marrëveshje përmes zbatimit të së cilës do të bëhen reforma që do ta ndryshojnë për të mirë vendin dhe shoqërinë. (*society, 2016*)

Në bazë të Raportit të Progresit të vitit 2019 (*commission, 2019*), Kosova ka shënuar progres në zbatimin e disa reformave kyçe me BE-në, po ashtu ka përmirësuar Kornizën Ligjore në fushat e sundimit të ligjit dhe administratës publike. Kuvendi ka arritur që të ketë shumicën për disa nga çështjet kryesore për Kosovën, e cila është demonstruar në ratifikimin e marrëveshjes për demarkimin e kufirit, kufirit administrativë me Malin e Zi dhe miratimin e reformave të rëndësishme legjislative në lidhje me BE-në. Megjithatë, kanë vazhduar të jenë të pranishme dobësitë e Kuvendit në funksionimin e tij në përgjithësi, kjo është dëshmuar nga mungesa e vazhdueshme e kuorunit, duke çuar kështu në vonesa në veprimtarinë legjislative.

Progres të limituar ka shfaqur në adresimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të Misionit të BE-së për vëzhgimin e zgjedhjeve parlamentare dhe komunale të mbajtura në vitin 2017. Situata në veri të Kosovës mbetet ende një situat veçanërisht sfiduese. Ka pasur progres në miratimin e

pakos së ligjeve për funksionimin dhe organizimin e administratës publike, zyrtarët publikë dhe pagat.

Janë bërë disa përparime sa i përket sistemit gjyqësor të Kosovës siç janë: miratimi i Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe Ligjit për Ndërmjetësim si dhe në fushën e sistemit elektronik të menaxhimit të rasteve. Megjithatë, Gjyqësori është ende i cenueshëm ndaj ndikimit të parregullt politik. Institucionet e sundimit të ligjit kanë nevojë për përpjekje të vazhdueshme që të ngritin kapacitetet e tyre pasi që ofrimi i drejtësisë mbetet i ngadalshëm dhe jo efikas.

Progres ka shënuar edhe ndaj luftës kundër korrupsionit përmes reformave legislative mjaft të rëndësishme në fushën e sundimit të ligjit në hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të nivelit të lartë. Po ashtu, progres është bërë edhe në konfiskimin e pasurisë edhe pse konfiskimet finale mbeten në nivel të ulët. Prapë se prapë, korrupsioni është mjaft i përhapur dhe vazhdon të mbetet një çështje shqetësuese.

Progres është shënuar në luftën kundër terrorizmit, veçanërisht në lidhje me krijimin e kushteve më të mira për rehabilitimin dhe riintegrimin e luftëtarëve terroristë në vende të huaja dhe familjeve të tyre. Autoritetet e Kosovës duhet të jenë më efektive në përpjekjet e tyre për të luftuar pastrimin e parave dhe ligji përkatës duhet të jetë në përputhje me acquistë BE-së dhe standardet ndërkombëtare.

Sa i përket kritereve ekonomike, Kosova është në një fazë të hershme dhe ka shënuar progres në zhvillimin e një ekonomie funksionale të tregut. Rritja ekonomike ishte e fuqishme, por situata shumë e vështirë e tregut të punës mbetet shqetësuese.

Sa i përket marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe bashkëpunimit rajonal, Kosova vazhdoi të merrte pjesë në shumicën e forumeve rajonale. Megjithatë, vendimi i Kosovës për të vendosur një taksë prej 100% në importet nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina ka dëmtuar përpjekjet e bashkëpunimit rajonal.

Kosova mbetet e angazhuar në dialog sa i përket normalizimit të marrëdhënieve me Sërbinë. Megjithatë, qeveria e Kosovës duhet të heqë taksat për importet nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina. Kosova duhet të bëjë përpjekje të mëtejshme të konsiderueshme për të krijuar një mjedis të favorshëm për përfundimin e një marrëveshjeje ligjore me Sërbinë. Një

marrëveshje e tillë është urgjente dhe vendimtare që Kosova dhe Serbia të përparojnë në rrugët e tyre evropiane.

Sa i përket harmonizimit me standardet evropiane, Kosova ka arritur një nivel të caktuar të përgatitjes. Harmonizimi legjislativ ka vazhduar në disa fusha, por zbatimi është i dobët. Në përgjithësi, Kosova duhet të përmirësojë kapacitetet e saj administrative dhe koordinimin, në të gjithë sektorët, për të siguruar zbatimin efektiv të *acquis*.

Ashtu siç u pa edhe nga Raporti i Progresit të 2019-ës, Shteti i Kosovës ka bërë progrese të vogla në drejtim të rrugës drejt Integritimit Evropian, por Kosova është e detyruar që të vazhdojë punën në reformat të cilat i kërkon BE-ja. Duke patur parasysh që Shteti i Kosovës nuk njihet ende nga pesë shtetet anëtare të BE-së mund ta marrim me mend edhe vështirësinë që e kemi.

Deri më tani, Republika e Kosovës ka të nënshkruar vetëm një marrëveshje me BE-në e cila është e para dhe e vetme kontraktuale dhe kjo është Marrëveshja e Stabilizim Asocimit. Ndërsa shtetasit e Kosovës janë të vetmit në Ballkanin Perëndimor të cilët ende nuk e kanë liberalizimin e vizave.

Kjo si pasojë e mos plotësimit të kriterit të BE-së për luftimin e krimit dhe korrupsionit. Marrëveshja për demarkimin e kufirit me Malin e Zi si dhe asociacioni i komunave me shumicë serbe, bashkë me këto edhe luftimi i krimit dhe korrupsionit është nënshkruar në gusht të vitit 2015, përderisa marrëveshja për demarkimin e kufirit është arritur të votohet në mars të vitit 2018, tre vite pas nënshkrimit, për arsye se opozita e atëhershme e vlerësoi si të dëmshme këtë marrëveshje duke pretenduar se Kosovës do t'i mirrej territor, mbi 8000 hektarë tokë. Ata kundërshtonin njëkohësisht edhe marrëveshjen për asociacionin e komunave me shumicë serbe, dhe u pat dërguar në Gjykatën Kushtetuese nga presidentja e atëhershme, me ç'rast, Gjykata pati vlerësuar që parimet e kësaj marrëveshje nuk janë tërësisht në përputhje me frymën e Kushtetueses, duke u bazuar në nenin 3 të saj dhe me të drejtat e komuniteteve në Kushtetutën e Kosovës.

## 4. METODOLOGJIA E PUNIMIT

Në këtë punim janë përdorur metodat krahasimore, historike, dhe ajo dogmatike- juridike.

**Metoda historike** – trajton pjesën e histories së Republikës së Kosovës se si ka ardhur deri te clirimi i saj dhe formimi i saj si shtet dhe po ashtu rrugëtimin drejt integritit të Bashkimit Evropian

**Metoda krahasimore** – Këtë metodë e kemi përdorur për krahasimin mes Kosovës shteteve rajonale si Shqipëria, Mali i Zi dhe Serbia, për të parë se ku kanë arritur ato me përmbushjen e kushtit për përafrimin e legjislacionit vendor me atë të BE-së.

**Metoda dogmatike- juridike** - Studimi dhe analizimi i mekanizmave shtetërore për përafrimin e legjislacionit vendor me atë të BE-së.



## 5. ANALIZA

### 5.1 Aspekti krahasimor

Të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor kanë një perspektivë evropiane, e cila u njoh për herë të parë gjatë Këshillit Evropian të Feira në vitin 2000. Kjo perspektivë evropiane është të integruar në Procesin e Stabilizim-Asociimit, që është politika e BE-së në raport me vendet e Ballkanit Perëndimor. Sipas këtij procesi, të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor kanë një të ardhme të përbashkët si shtetet anëtare të BE-së. (Comission, 2020)

Të gjitha këto shtete duhet të bëjnë përmirësime dhe progrese sa i përket formimit të demokracisë në rregullim të ligjit dhe të drejtave themelore të njeriut, reformimit të administratës publike, forcimit të konkurrencës në zhvillimin biznesor, të punojnë drejt një ambienti më të pastërdhe që ushqimet të jenë më të sigurta.

<b>KOSOVA</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>-Prill 2013 “Marrëveshja e Brukselit” nëmes Prishtinës dhe Beogradit u nënshkrua.</li><li>-Prill 2016, hyn në fuq i Marrëveshja e StabilizimAsociimit.</li><li>-Maj 2016, Komisioni Evropian propozon liberalizimin e vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës.</li><li>-Tetor 2016, takimi i pare mes Bashkimit Evropian dhe Stabilizim Asociimit të Kosovës.</li><li>-Korrik 2018, Komisioni konfirmon se Kosovai ka përmbushur të gjitha kriteret për librealizimin e vizave. Propozimi i Komisionit është në pritje të Këshillit.</li><li>-Kosova është shtet i mundshëm kandidat.</li></ul>
<b>SHQIPËRIA</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>-Prill 2009, Aplikimi për anëtarësimin në BE dhe hyn në fuqi Marrëveshja për Stabilizim dhe Asociim.</li><li>-Dhjetor 2010, liberalizimi i vizave.</li><li>-Qershor 2014, statusi për shtet kandidat.</li><li>-Maj 2019, Komisioni rekomandon hapjen e negociatave për pranim.</li></ul>
<b>MALI I ZI</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>-Dhjetor 2008, aplikimi për anëtarësimin në BE.</li><li>-Maj 2010, hyn në fuqi Marrëveshja për Stabilizim Dhe Asociim.</li><li>-Dhjetor 2010, statusi për shtet kandidat.</li><li>-Qershor 2012, hap negociatat për pranim.</li><li>-Dhjetor 2019, 32 nga 35 Kapituj të Negociatave janë hapur përderisa 3 kapituj janë perkohësisht të mbyllur.</li></ul>
<b>SERBIA</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>-Dhjetor 2009, aplikimi për anëtarësim në BE, dhe liberalizimi I vizave.</li><li>-Mars 2012, statusi për shtet kandidat.</li><li>-Shtator 2013, hyn në fuq i Marrëveshja për Stabilizim dhe Asociim.</li><li>-Janar 2014, hap negociatat për pranim.</li><li>-Dhjetor 2019, 18 nga 35 kapituj janë hapur përderisa 2 janë mbyllur perkohësisht.</li></ul>

## 6. KONKLUZIONI

Përfundimisht potencoi se Republika e Kosovës është duke punuar në plotësimin e kushteve për sa i përket integriteteve Evropiane e sidomos në kushtin themelor për hyrje në BE, i cili ishte edhe tema kryesore e këtij punimi. Pra, Kosova edhe pse me statusin e saj të pazgjdhur ajo po tenton t'i plotësojë kushtet e vendosura në Kopenhagë në vitin 2003.

Përafrimi i legjislacionit është një proces mjaftë i ndërlikuar si për Kosovën ashtu edhe për vetë shtetet anëtare të Be-së. Kosova po ashtu nuk e ka ende statusin për shtet kandidat në hyrje në Bashkimin Evropian. Por, ajo ka një marrëdhënie kontraktuale e cila është Marrëveshja për Stabilizim dhe Asociim (MSA) e cila hyri në fuqi në prill të vitit 2016. Marrëveshje e cila ka ndihmuar rrugën për realizimin e plotësimin të këtij kriteri i cili ende nuk ka ndodhur.

Megjithatë me të gjithë reformat e bëra e me themelimin e institucioneve për përafrimin e ligjeve vendore me ato të Be-së ende kanë mangësi dhe sfida pasi sic është cekur edhe më lartë rrugëtimi drejt Be-së është i vështirë dhe mjaftë sfidues.

Republikës së Kosovës i duhet punë edhe më i madh në plotësimin e këtij kriteri i cili është edhe një ndër kushtet bazë sa i përket hyrjes në BE-së të cilën shteti i Kosovës ka kohë që e ëndërron.

BE-ja ka bërë premtim se të gjitha vendet e Ballkanit, duke përfshirë edhe Kosovën, e kanë ardhmërinë në BE. Megjithatë, ata e bënë të qartë se, progresi i çdo vendi drejt BE-së do të varet nga meritat e tyre në plotësimin e Kriterëve të Kopenhagenit si dhe kushteve të parapara me PSA. Për këtë arsye, qeveria e Kosovës me ndihmën e BE-së duhet të punojë për plotësimin e këtyre kushteve, në mesin e të cilave, përafrimin e legjislacionit në mënyrë që t'i bashkohet familjes së madhe të BE-së sa më shpejt që është e mundur.

## 7. LITERATURA

- Anon., 2004. *Bashkimi Evropian sqaron: Zgjerimi*, Bruksel: s.n.
- Bjarnason, 2010. *the political economy of joining the european union*. s.l.:s.n.
- center, E., 2020. *Integrimi Evropian*. [Online].
- CENTRE, C., n.d. *Çfarë duhet të dini për marrëveshjen për stabilizim dhe asociim ndërmjet BE-së dhe Kosovës*. [Online].
- comission, E., 2016. *Condition for membership*, s.l.: s.n.
- Comission, E., 2018. *2018 Communication on EU Enlargement Policy*, Strasbourg: s.n.
- Comission, E., 2019. *2019 Communication on EU Enlargement Policy*, Brussels: s.n.
- Comission, E., 2019. *European Neighbourhood Policy And Enlargement Negotiations*. [Online].
- Comission, E., 2020. [Online].
- Comission, E., n.d. *Eu enlargment*, s.l.: s.n.
- commission, E., 2018. *2018 Communication on EU Enlargement Policy*, Strasbourg: COMMISSION STAFF WORKING DOCUMENT.
- commission, E., 2018. *RADNI DOKUMENT KOMISIJE*, Strazburg: s.n.
- Commission, E., 2019. *2019 Communication on EU Enlargement Policy*, Brussels: s.n.
- commission, E., 2019. *COMMISSION STAFF WORKING DOCUMENT*, Brussels: Communication on EU Enlargement Policy.
- commission, E., 2019. *COMMISSION STAFF WORKING DOCUMENT*, Brussels: s.n.
- commission, E., 2019. *Komunikata 2019 për Politikën e Zgjerimit të BE-së*, Bruksel: s.n.
- Council, E., 2010. [Online].
- Drejtësi, M. e., 2010. *Manual per hartimin e legjislacionit*. [Online].
- Economy, M. o., 2016. *Approximation of the legislation with EU Acquis on free movement of services*. [Online].
- Europa, n.d. *Procesi i stabilizim asociimit*. [Online].
- Europe, 2019. *Guide to the Approximation of European Union Environmental Legislation*. [Online].
- EuropeHouse-Kosovo, 2016. *Understanding enlargment*, s.l.: s.n.
- Evropiane, M. e. i., 2017. [Online].
- Evropian, K., 2016. *Te kuptuarit e zgjerimit Evropian*, s.l.: s.n.

Evropian, M. e. I., 2017. [Online].

integracije, C. G. i. e., n.d. *Razvoj odnosa crne gore i EU*. [Online].

Kosoves-Presidenti, R. e., 2020. *Strategjia kombetare per integrimen evropiane*. [Online].

Kosoves, R. e., 2014. *UDHËZIME PRAKTIKE PËR*. [Online].

Kosoves, R. e., 2017. *National Programme for Implementation of the Stabilisation and*, Prishtine: s.n.

Kosovo, R. o., 2010. *Rregullore e kuvendit te Republikes se Kosoves*, s.l.: s.n.

Kryeministrit, Z. e., 2018. [Online].

Monitor, 2018. Hapat e rrugëtimit të gjatë drejt Europës; Shqipëria pret sot dritën jeshile për hapjen e negociatave me BE.

network, E. i., 2016. *Anetaresimi i Shqiperise ne Bashkimin Evropian*. [Online].

OECD, 2013. *Copenhagen criteria*, s.l.: s.n.

OSCE, 2008. *Environment as a medium for promoting democracy and economic development in societies in transition*. [Online].

policy, E., 2017. *Rrugetimi i shqiperise drejt bashkimit evropian*. [Online].

Serbia, O. c. J. o. t. R. o., 2011. *NATIONAL ENVIRONMENTAL*. [Online].

society, K. f. f. o., 2016. [Online].

Stancic, 2002. *od kuca do kuca*. novi sad: s.n.

Ujkani, E., 2012. *E drejta e bashkimit evropian*. Prishtine: LexLibri Press.

Veri, N. A. T. O. (. O. e. t. a. n., n.d. [Online].

Wilhelmsson, 2004. *Varieties of Welfarism in European Contract Law*. s.l.:s.n.

Zyra e Unmikut per integrimen Evropiane, 2006. *Plani i veprimit per implementimin e partneritetit Evropian*, s.l.: s.n.